




Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Zyra e kryetarit të komunës

Në mbështetje nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 12 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, dhe në bazë të vendimit nr.320/17 të datës 20.03.2017, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, shpall:

KONKURS

Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

Drejtoria për Administratë- Komuna e Vushtrrisë

Vendet e punës: Zyrtarë të gjendjes civile

Numri i ekzekutuesve: Tre(3)

Lloji i pozitës: Marrëveshje për shërbime të veçanta (kohëzgjatja 6 muaj, pa mundësi vazhdimi)

Orari i plotë: 40 orë në javë

Paga: 291.36 euro bruto

Qëllimi i vendit të punës:

- Ofrimi i shërbimeve për qytetarët në Zyrën e Gjendjes Civile

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

1. Verifikimi i qytetarëve në regjistrin e themeltar elektronik dhe unifikimi i të dhënave dhe shënimeve me regjistrat themeltar fizik,
2. Mirëmbajtja dhe kujdesi i regjistrit themeltar dhe qendror si në aspektin fizik dhe elektronik dhe të dokumenteve të arkivuara.
3. Përditësimi i shënimeve dhe regjistrimi i shtetasve në regjistrin themeltar dhe qendror,
4. Përdorimi dhe zbatimi i ligjeve dhe udhëzimeve që kanë të bëjnë me gjendjen civile
5. Përdorimi dhe shfrytëzimi i aplikacionit të GJC sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë fushë,
6. Regjistrimi i fakteve të gjendjes civile si lindje, martesë dhe vdekje.

Kualifikimi profesional, aftësitë, përgjegjësitë:

Diplomë universitare

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjisin: **Kopjen e vërtetuar të diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, certifikatën që nuk është dënuar dhe nën hetime. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Njësinë e personelit (zyra numër 8), nr. i tel. **028-572-416**.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku